

2024

Raporti i ecurisë

MILIEUKONTAKT SHQIPËRI



PERMBAJTJA:

Mesazh nga Drejtuesja Ekzekutive	03
Angazhimi ynë kombëtar me shoqërinë civile	05
Angazhimi ynë ndërkombëtar	07
2024 në shifra	09
Shikueshmëria dhe media	36
Artikuj në median e shkruar	38
Botime	39
Vizioni i së ardhmes	44
Transparenca dhe pasqyrat financiare	46

01

Mesazh nga Drejtuesja Ekzekutive



Valbona Mazreku

Viti 2024 është një tjetër vit i rëndësishëm për Milieukontakt Shqipëri, gjatë të cilit zbatuam mbi 11 projekte individuale dhe shumëpalëshe, duke qëndruar besnikë ndaj misionit tonë: përmirësimi i cilësisë së jetesës përmes mbrojtjes së mjedisit, shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, si dhe promovimit të pjesëmarrjes qytetare, solidaritetit dhe përfshirjes sociale për një të ardhme të qëndrueshme.

Edukimi është gjithmonë shtylla kryesore e veprimtarisë sonë. Edhe gjatë vitit 2024, vijuem me fushata dhe programe edukative në nivel lokal e kombëtar, për të rritur ndërgjegjësimin mbi qëndrueshmërinë, teknologjinë dhe mënyrat e jetesës miqësore me mjedisin.



Përmes nismës “**Heroi i Klimës**”, kontribuuam në formimin e një brezi të ri qytetarësh të informuar dhe të angazhuar, të cilët promovojnë sjellje të përgjegjshme mjedisore për të ndikuar pozitivisht në përballimin e ndryshimeve klimatike. Më shumë se 80 të rinj iu bashkuan kësaj nisme dhe, përmes veprimeve të tyre, frymëzuan komunitetet përreth, duke na bërë të besojmë se Akademia RikLima duhet të kthehet në një traditë të përvitshme. Të gjitha këto arritje nuk do të ishin të mundura pa bashkëpunimin e ngushtë me partnerët tanë. Partneritetet me organizatat e shoqërisë civile, institucionet publike dhe sektorin privat kanë qenë thelbësore në ndërtimin e urave të bashkëpunimit ndërsektorial për të adresuar sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Angazhimi ynë në fushën e **energjisë** vijoi edhe këtë vit përmes pjesëmarrjes në Lëvizjen për Energjinë dhe Klimën. Së bashku me organizata të tjera, kemi avokuar për zhvillimin e burimeve të rinovueshme, demokratizimin e energjisë dhe për një Shqipëri që në vitin 2030 të mbështetet plotësisht në burime të ripërtëritshme. Megjithatë, qëndrimet e forta kërkojnë edhe veprime konkrete. Për këtë arsye, kemi punuar për fuqizimin e grave dhe grupeve vulnerabël, duke adresuar varfërinë energjetike dhe mundësuar pjesëmarrjen e tyre si prodhues dhe konsumatorë të energjisë së pastër.

Në vitin 2024, vazhduam me zbatimin e nismës “**Përdor më pak plastikë**”, duke ndihmuar bizneset HORECA (Hotele, Restorante, Kafene) të reduktojnë përdorimin e plastikës njëpërdorimshe. Janë audituar 714 biznese, të cilat janë këshilluar për zëvendësimin e plastikës me alternativa të qëndrueshme që tashmë janë të pranishme në treg. Përdorimi i teknologjive digjitale ka lehtësuar ndërlidhjen ndërmjet ekspertëve të mjedisit dhe bizneseve, duke ofruar zgjidhje konkrete që përkrahin një ekonomi dhe turizëm të qëndrueshëm.

Angazhimi ynë kombëtar me shoqërinë civile

02

Çështjet e mjedisit, energjisë, ndryshimeve klimatike dhe ndikimit të tyre në shëndetin publik kanë qenë ndër më të rëndësishmet dhe më të diskutuara në Shqipëri gjatë vitit 2024. Si rrjedhojë, edhe puna e shoqërisë civile është përqendruar gjithnjë e më shumë në këto tema. Organizatat mjedisore kanë ndjekur me vëmendje zhvillimet politike dhe kanë qenë të angazhuara në debatet publike, duke kundërshtuar çdo politikë që rrezikon zhvillimin e qëndrueshëm, mbrojtjen e mjedisit dhe cilësinë e jetës së qytetarëve. Ato kanë kërkuar jo vetëm përfshirjen e qytetarëve në këto procese, por edhe mbështetjen e tyre për të nxitur ndryshime pozitive.

Një shtyllë tjetër e rëndësishme në këtë përpjekje ka qenë media, si ajo e shkruar ashtu edhe ajo vizive, e cila ka mbuluar me profesionalizëm problematikat mjedisore dhe ka zbuluar afera korruptive të cilat, nën maskën e zhvillimit ekonomik, kanë sjellë dëmtime të zonave të mbrojtura dhe të mjedisit në tërësi. Partneriteti mes shoqërisë civile, qytetarëve dhe medias ka luajtur një rol kyç në monitorimin e zbatimit të politikave mjedisore, duke ushtruar presion për politika më të përgjegjshme, duke luftuar korrupsionin dhe duke sensibilizuar opinionin publik.

Ne, si pjesë e shoqërisë civile prej 2 dekadash, kemi thelluar angazhimin tonë në çështjet mjedisore, duke ofruar ekspertizë, studime të detajuara, shembuj të praktikave më të mira nga vendi dhe rajoni, si dhe duke artikuluar çështje mjedisore si në vend ashtu edhe në arenën ndërkombëtare. Qëllimi ynë është ndalimi i degradimit të mjedisit dhe kontributi në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Zhvillimi i qëndrueshëm nuk është vetëm një zgjedhje, por një detyrim ndaj brezave që vijnë. Milieukontakt mbetet i palëkundur në përpjekjet për një Shqipëri më të pastër, më të gjelbër dhe më të drejtë për të gjithë. Gjatë vitit 2024, kemi forcuar bashkëpunimin me Bashkinë e Lushnjës, nxënësit dhe mësuesit e këtij komuniteti, duke organizuar aktivitete ndërgjegjëse, sesione informimi,

bashkëpunime me bizneset lokale, si dhe duke hartuar udhëzues për mësuesit mbi mënyrat e integritit të OZHQ-ve në mësimdhënie. Gjithashtu, një shkollë verore me pjesëmarrje rajonale ka lënë ndikim të qëndrueshëm tek të rinjtë dhe familjet e tyre. Ne besojmë se edukimi mjedisor i fëmijëve nuk ndodh vetëm përmes librave, por sidomos përmes përfshirjes aktive, diskutimit dhe nismave konkrete që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, traditës dhe kulturës vendore.

Ndryshimet klimatike përbëjnë një sfidë globale, e cila është veçanërisht e rëndë për vende me ekonomi të brishtë si Shqipëria. Pasojat e tyre në mjedis dhe shëndet janë të ndjeshme, dhe kërkojnë jo vetëm studim e monitorim të vazhdueshëm, por edhe masa konkrete përshtatëse, përfshirë zgjidhje të bazuara në natyrë, ashtu siç kanë vepruar të parët tanë në të kaluarën.

Në këtë kuadër, Akademia Riklima ka vënë në qendër të punës së saj ndërgjegjësimin e të rinjve mbi ndryshimet klimatike dhe sjelljet e tyre miqësore ndaj mjedisit. Një grup të rinjsh është njohur me sfidat mjedisore që përballët vendi ynë, duke punuar së bashku me ekspertë për të identifikuar masa rehabilituese, për të hartuar propozime dhe për të ndarë përvoja konkrete të jetës së përditshme në mbrojtje të mjedisit, klimës dhe jetës në Tokë.

Lëvizja për Energjinë dhe Klimën përfaqëson një grupim ad hoc të organizatave mjedisore, ekspertëve të energjisë dhe klimës, akademikëve dhe bizneseve, me synimin për të kontribuar në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike deri në vitin 2030. Si një anëtar aktiv i kësaj lëvizjeje, Milieukontakt Shqipëri, si pjesë e lëvizjes, është i angazhuar në promovimin e komuniteteve qytetare të energjisë, si një mënyrë për të forcuar demokracinë vendore dhe për të fuqizuar qytetarët në tranzicionin energjetik.

‘Ne nuk e kemi trashëguar Tokën nga të parët tanë, e kemi marrë hua nga fëmijët tanë’. Është koha të veprojmë me përgjegjësi, me vizion dhe me guxim.”

03

Angazhimi ynë Ndërkombëtar

Njerëzimi sot po përballët me kriza të ndërlidhura politike, ekologjike dhe ekonomike, ndërkohë që angazhimet globale për t'i adresuar këto sfida po zbehen gjithnjë e më shumë. Hapësira për veprim të shoqërisë civile po ngushtohet në mënyrë shqetësuese, ndërsa shpenzimet ushtarake rriten në shkallë globale.

Shumë qeveri vijojnë të trajtojnë shoqërinë civile si ofruese shërbimesh, duke kufizuar rolin e tyre kritik në advokim për çështje mjedisore dhe klimatike. Disa madje kanë hedhur poshtë tërësisht Axhendën 2030, duke minuar multilateralizmin dhe përpjekjet për të adresuar krizën e trefishtë planetare: ndryshimet klimatike, ndotjen dhe humbjen e biodiversitetit. Por përballë këtyre sfidave, shoqëria civile ka zgjedhur të qëndrojë më e bashkuar se kurrë — duke marrë pjesë aktive në tryeza ndërkombëtare, duke artikuluar qarte qëndrimet e saj dhe duke propozuar masa konkrete për zgjidhje efektive.

Sepse, nëse shoqëria civile nuk është

pjesë e tavolinave të vendimmarrjes, rrezikon të mbetet thjesht pjesë e "menusë".

Dhe ky është një realitet që sektori ynë nuk e pranon. Vendosmëria jonë është e palëkundur.

Pikërisht për këtë arsye, Milieucontact Shqipëri ka qenë pjesë aktive e forumeve dhe nismave ndërkombëtare, duke kontribuar në fushat më kritike të zhvillimit të qëndrueshëm:

Menaxhimi i integruar i mbetjeve dhe substancave të rrezikshme:

Plastikat, pesticidet dhe kimikatet e rrezikshme të pranishme në përdorimin e përditshëm paraqesin rreziqe serioze për shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit. Mbështesim politika që i detyrojnë ndotësit të zëvendësojnë substancat e dëmshme me alternativa të sigurta dhe të qëndrueshme. Po ashtu në bashkëpunim me Rrjetin e Veprimit të Bazelit kemi punuar për rritjen e transparencës dhe informimit mbi eksportin e paligjshëm të mbetjeve

nga Shqiperia drejt vendeve që nuk kanë praktika të qëndrueshme menaxhimi mjedisor.

Akses në ujë të pastër: Në shumë komunitete, burimet ekzistuese të ujit nuk janë të mbrojtura siç duhet dhe shpesh janë të kontaminuara nga baktere, nitrate apo pesticide. Qasja në ujë të sigurt është një e drejtë themelore njerëzore. Trajnimet tona mbi Planifikimin e Sigurisë së Ujit dhe Higjienës ndihmojnë komunitetet të kuptojnë rreziqet dhe të zbatojnë zgjidhje ekologjike për trajtimin e ujërave të ndotura.

Drejtësi klimatike: Ndryshimet klimatike godasin më fort ata që kanë kontribuar më pak në to. Në tryezat me politikëbërës, ne avokojmë për një tranzicion drejt energjisë së pastër që respekton të drejtat e njeriut, ku zëri i të gjithë qytetarëve, sidomos i më të prekshmeve dëgjohet dhe përfshihet në vendimmarrje.

Energjia e rinovueshme dhe barazia gjinore: Gratë janë në mënyrë

disproporcionale të prekura nga krizat energjetike, ndërkohë që pjesëmarrja e tyre në sektorin energjetik mbetet e ulët. Ne punojmë për të ndërtuar zgjidhje të qëndrueshme energjetike që janë të ndjeshme ndaj gjinisë dhe të përshtatura për zonat me të ardhura të ulëta, duke promovuar liderшипin e grave dhe zbatimin lokal të Marrëveshjes së Gjelbër.

Milieukontakt është pjesë aktive e rrjeteve ndërkombëtare dhe së bashku, ngremë zërin për të reflektuar problematikat mjedisore në mënyrë të denjë në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe për të nxitur përgjegjshmëri më të madhe nga qeveritë për një të ardhme të sigurt dhe të drejtë për të gjithë.

"Bota po lëkundet mes përshpejtimit të krizave dhe mundësive për transformim. Ne zgjedhim të jemi pjesë e zgjidhjes – me zë, me dije, me veprim dhe mbi të gjitha, me bashkëpunim."

2024 NË SHIFRA

04

Bashkëpunëtorë 881

Ekspertë 46

Nxënës dhe studentë 974

Bashki 31

Mësues 26

Qytetarë 8019

Donatorë 13

Botime 14

Projekte në zbatim 12

Zhvillimi i Qëndrueshëm



Të rinjtë për një të ardhme të qëndrueshme

janar - nëntor 2024

Projekti “Të rinjtë për një të ardhme të qëndrueshme” synoi ndërgjegjesimin dhe rritjen e kapaciteteve, të të rinjve të Lushnjës dhe të Fushë Kosovës mbi zhvillimin e qëndrueshëm.

Nxitja e një ndryshimi transformues në qëndrimet dhe sjelljet në lidhje me mbrojtjen e natyrës dhe praktikën e qëndrueshme tek të rinjtë dhe promovimi i një stili jetese të qëndrueshëm.

Informimi/edukimi dhe angazhimi i të rinjve në Lushnje dhe Fushë Kosovë për rëndësinë e një mjedisi të pastër, si një komponent thelbësor që garanton një cilësi të mirë jetese dhe me standarde.

Rritja e bashkëpunimit midis komunitetit dhe bashkive për përmirësimin e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij, duke vepruar veçanërisht për klimën, tokën dhe ujin.



Rezultatet:

- Mbi 130 nxënës të shkollave “Skënder Libohova” dhe “Mihal Grameno” morën pjesë në aktivitetet e pastrimit.
- 168 pemë bliri dhe kumbulle iu shtuan fondit të drurëve dekorativ në të dy qytetet.
- Orë të hapura edukimi mjedisor me 20 klasa të ndryshme (603 nxënës)
- Mbi 754 nxënës të të dy shkollave nga klasat më të ulta në ato më të larta morën pjesë në Atelie 2024 dhe prezantuan se si duan ta shohin ato qytetin ku jetojnë.
- Kampi veror bashkoi mbi 40 të rinj nga Shqipëria dhe Kosova për tre ditë në sesione interaktive, lojëra dhe vizita në objektet historike të qytetit.
- 45 kosha për mbajtjen pastër të ambienteve të shkollës



AKTORËT	PARTNERËT	DONATORI
Nxënësit e shkollave “Skënder Libohova” dhe “Mihal Grameno”; Publiku i gjerë	INDEP; Bashkia Lushnjë; Komuna Fushë Kosovë	Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 – ReLOaD2, financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në Mirditë përmes promovimit të trashëgimisë kulturore

mars 2023- 2024

Ky projekt do të zhvillojë mundësitë socio-ekonomike dhe kulturore si një mjet për rigjallërimin e komuniteteve dhe zhvillimin ekonomik lokal. Aktivitetet në këtë projekt do të promovojnë kulturën, traditat dhe vlerat natyrore të zonës, të cilat do të bëhen të aksesueshme për publikun dhe turistët dhe mbi të gjitha duke kontribuar në zhvillimin socio-ekonomik.

Aktivitetet e projektit kanë për qëllim prezantimin e rolit të trashëgimisë kulturore para publikut si një shtytës i zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik, gjithashtu për të përfshirë autoritetet publike, modele gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme gjinore si dhe për të forcuar kapacitetet profesionale të individëve, grupeve lokale që punojnë për trashëgiminë kulturore, zhvillimin e qëndrueshëm dhe turizmin.



Rezultatet:

- Identifikimi i aftësive ekzistuese dhe të humbura, boshllëqeve dhe burimeve në fushën e artit, artizanatit (gdhendje në gur dhe dru, pirografi, qëndisje, artizanat me bakër, punime kashte dhe veshje tradicionale) dhe shërbimet turistike duke përfshirë gratë dhe të rinjtë e zonave rurale.
- 4 module trajnimi të përgaditura për çdo kurs profesional (shërbim turistik, qëndisje, pirografi, guidë turistike);
- 4 shtigje natyrore të pastruara dhe të markuara;
- 109 pjesëmarrës përfshirë dhe të rinj morën pjesë në kurset profesionale 5 ditore (61 gra);

- Së paku 15 vajza të reja filluan të prodhojnë punime me dorë duke përdorur simbole tradicionale;
- 23 biznese të vogla dhe potenciale u trajnuan se si të zhvillojnë biznesin e tyre duke marrë parasysh turizmin e qëndrueshëm (17 gra);

AKTORËT	PARTNERËT	DONATORI
100 të rinj e gra nga Mirdita, 20 biznese të mesme dhe të vogla, OJF lokale, 10 praktikues individualë të vendeve kulturore, vizitorë vendas dhe të huaj.	Bashkia Mirditë	Programi EU4Culture, financuar nga BE, zbatuar nga UNOPS në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës

Të Rinjtë për Ndryshimet Klimatike (RIKLIMA)

gusht - dhjetor 2024

Projekti “Të Rinjtë për Ndryshimet KLIMAtike” synon nxitjen e një ndryshimi transformues në qëndrimet dhe sjelljet e të rinjve mbi ndryshimet klimatike, si edhe fuqizimin e tyre përmes promovimit të praktikave miqësore me mjedisin. Përmes një cikli leksionesh, vizitave në terren, fushatave ndërgjegjëse online dhe dialogut me institucionet vendore dhe ekspertë të fushës, projekti do informojë të rinjtë mbi ndryshimet klimatike, veprimet që ata mund të ndërmarrin dhe fuqizimin e tyre si aktorë aktivë për një komunitete më të sigurta dhe një cilësi më të mirë jetese. Fushata në median sociale “Heroi i Klimës” synoi mbi 80 të rinj të bëhen pjesë e saj dhe përmes disa veprimeve të vogla, të kontribuojnë pozitivisht në veprime të përditshme klimatike!



Rezultatet:

- 22 të rinj morën pjesë në aktivitet në terren për vlerësimin e fakteve mbi problematikat më shqetësuese mjedisore pasojë e ndryshimeve klimatike, mbledhjen e të dhënave dhe gjetjen e zgjidhjeve / masa të ndërhyrjes në dy zona të bashkisë Tiranë
- Dialogu dhe advokimi i të rinjve me bashkinë për më shumë buxhet / projekte me zgjidhje mjedisore.
- Fushata në median sociale “Heroi i Klimës” ka përqasur përmes medias sociale (Fb dhe Instagram) të rinj nga organizata të shoqërisë civile si ato mjedisore, rinore, grave etj., të cilët ndërmarrin veprime të vogla në ruajtjen e mjedisit. Ekspertja e komunikimit ka angazhuar edhe të rinjtë e akademisë Riklima për të qënë pjesë e fushatës dhe promovuar atë.



AKTORËT	PARTNERËT	DONATORI
Të rinj, publiku i gjerë, media	Bashkia Tiranë	Bashkia Tiranë


Qeverisje demokratike dhe ndërtim kapacitetesh



Mbështetje në nivele të ndryshme për përmirësimin e efijencës së energjisë në ndërtesat në Kosovë dhe Shqipëri

tetor 2023- shtator 2025

Projekti “Mbështetje në nivele të ndryshme për përmirësimin e efijencës së energjisë në ndërtesat në Kosovë dhe Shqipëri” (RenovAID), adreson çështjen e përmirësimit të efijencës energjetike të ndërtesave duke ofruar mbështetje strukturore në shumë nivele vendimarrje. Arsyeja themelore pas RenovAID-it është rëndësia e efijencës së energjisë në tranzicionin e energjisë, pasi ndihmon përballueshmërinë, sigurinë e furnizimit dhe veprimet ndaj klimës. Meqenëse në të dy vendeve ku do të realizohet projekti mungojnë kornizat adekuate të politikave, renovAID synon të ofrojë mbështetje gjithëpërfshirëse në këtë aspekt të tranzicionit energjetik dhe objektivi është të lehtësojë krijimin e politikave në mbështetje të efijencës së energjisë dhe masave me ndikim - duke përfshirë Çertifikatën e Performancës së Energjisë dhe pika me një ndalesë për rinovimin e shtëpive. RenovAID gjithashtu do t'i kushtojë vëmendje të veçantë çështjes së varfërisë energjetike për të mundësuar marrjen e masave mbështetëse për grupet vullnerabël.



Rezultatet:

Projekti RenovAID bazohet në një qasje në shumë nivele

- Rregullator: rritja e kapaciteteve të administratave publike në Kosovë dhe Shqipëri për të krijuar politika të efijencës së energjisë që është e favorshme dhe e harmonizuar me rregulloren e BE-së

- Informimi: pajisja e administratës publike me aftësitë e nevojshme për krijimin e bashkëpunimit ndërsektorial me aktorë të tjerë dhe nisjen e fushatave efektive të informacionit.
- Stimulimi: trajnimi i grupeve të synuara për ngritjen e dyqaneve me një ndalesë, të cilat ofrojnë stimuj për pronarët e ndërtesave për të kryer rinovimin. Arsyeja pas kësaj qasjeje është se çështjet kryesore të identifikuara në vendet e synuara kërkojnë mbështetje gjithëpërfshirëse dhe sistematike – veprime që jo vetëm do të eliminojnë barrierat ekzistuese, por edhe do të stimulojnë ndryshimin

AKTORËT	PARTNERËT	DONATORI
NJQV, Agjencia e Eficencës së Energjisë OSHC-te; qytetarët	WiseEuropa Energiaklub INDEP BGF	Ministria Federale e Çështjeve ekonomike dhe veprimeve për klimën në Gjermani, zbatuar nga programi EUKI

Ngritja e pesë komuniteteve të energjisë së rinovueshme në Bashkinë Përmet

dhjetor 2023- prill 2024

Ky projekt synon të përgatisë kushtet për ngritjen e pesë Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme në bashkinë e Përmetit me synim parësor gjenerimin e energjisë diellore për të ulur kostot aktuale të energjisë elektrike për funksionimin e pompave të ujitjes.

Stacionet e pompimit janë në fshatrat Piskovë, Pacomit, Kutal-Bodar, Qilarisht dhe Kaludh. Prej disa vitesh, këto stacione pompojnë ujë sipërfaqësor nga lumi Vjosa me një kapacitet rreth 40-80 litra/sekondë.

Projekti do të hartojë një studim fizibiliteti që do të shërbejë për të zgjuar interesin e donatoreve dhe institucioneve financiare për të përmirësuar dhe modernizuar sistemin e ujitjes duke përdorur energjinë e rinovueshme nga panelet Fotovoltaike. Padyshim investime të tilla do të ndihmojnë fermerët që së bashku me bashkinë të kthehen në prodhues dhe konsumues të energjisë, si dhe do të ndihmojnë bashkinë që të rrisë investimet në sektorë të tjerë.



Rezultatet:

- Saktësimi i kriterëve ligjore për ngritjen e Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme.
- Përgatitja e udhërrëfyesit për angazhimin dhe mobilizimin e qytetarëve në Komunitetin e Energjisë së Rinovueshme.
- Përshkrimi i organigramit, rolet dhe përgjegjësitë, pronësia e aseteve, flukset financiare brenda Komunitetit të Energjisë së Rinovueshme.
- Analizat Teknike/Energjiko-Ekonomike të stacioneve të pompimit dhe sistemeve të ujitjes.



AKTORËT	PARTNERËT	DONATORI
OJF-te vendore; fermerët e Përmetit Agjencia e Eficencës së energjisë	Bashkia Përmet	SECO – Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike në Zvicër

Mjedisi dhe shëndeti



Menaxhimi i riskut në sektorin e ujit, higjenës dhe mikroplastikës në rajonin e Ballkanit

mars 2023- qershor 2025

Aktivitetet e projektit zhvillohen në Rumani, Maqedoninë e Veriut, Shqipëri dhe Serbi, ku ka mungesa për sigurinë e ujit dhe menaxhimin e higjenës në zonat rurale, situatë që mund të shkaktojë pasoja serioze për mjedisin dhe shëndetin e popullatës. Qëllimi ynë është të përshtasim e të zhvillojmë më tej instrumentin e Ujit dhe Planifikimin e Sigurt të Higjenës (WSSP). Projekti zhvillon metoda për analizën e riskut dhe vlerësimin e ujit e higjenës, duke treguar masat që mund të merren për të minimizuar riskun dhe për të përmirësuar situatën



Rezultatet:

- Kualifikimi / trajnimi i 30 mësuesëve
- Kualifikimi / trajnimi i 65 nxënësve
- Ndërgjegjësimi dhe edukimi për higjenën, praktikat e mira dhe konsumit të ujit të pastër nëpërmjet institucioneve të arsimit; nxënësve dhe mësuesve.
- Publikimi i "Mdouli i Ujit" si material ndihmës mësimor për mësuesit e shkollave 9 vjeçare duke i bërë orët mjaft praktike përmes eksperimenteve.
- Publikimi "Stop Plastikës", projektuar për fëmijët dhe të rinjtë në klasat 5-6, 7-8 dhe 9-10.


- Nxënësit fituan njohuri të reja dhe të rëndësishme lidhur me menaxhimin e ujit, higjienën dhe impaktin e mikroplastikës në mjedis. Kjo i bëri ata të kuptojnë më mirë rëndësinë e ruajtjes së burimeve natyrore dhe të promovojnë sjellje të shëndetshme për mbrojtjen e mjedisit.
- Publikimi i Rekomandimeve për Veprim mbi Drejtësinë gjinore në sektorin WASH; Sigurimin e aksesit të barabartë në objektet e ujit, kanalizimeve dhe higjienës; Varfëria dhe produktet menstruale.

AKTORËT	PARTNERËT	DONATORI
Komuniteti pranë qytetit të Tiranës, Institucionet e arsimit mësuesit, nxënësit	WECF, Gjermani; Gruaja në Zhvillim, Shqipëri; Acuademica, Rumani; Gazetarët për të Drejtat e Njeriut, Maqedonia e Veriut; Ambasadorët e Mjedisit për Zhvillimin e Qëndrueshëm, Serbi.	SECO – Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike në Zvicër

Iniciativa përdor më pak plastikë

tetor 2023- dhjetor 2024

Objektivi i projektit është të motivojë mbi 700 biznese të sektorit HoReCa, hotele, restorante, kafene dhe dyqane të vogla që të ulin përdorimin e plastikës njëpërdorimshe, gjetja e zgjidhjeve alternative më të qëndrueshme dhe evidentimi i përfitimeve që kjo iniciativë do të sjelli tek bizneset që do të ndërmarrin këto masa. Këto biznese që operojnë në 14 bashki të Shqipërisë; Tiranë, Vlorë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Belsh, Fier, Berat, Kavajë, Lushnje, Tepelenë, Gjirokastrë, Pogradec dhe Korçë u mbështetën përmes 9 koordinatorëve lokalë të identifikojnë dhe më pas të marrin masa për reduktimin e plastikës një përdorimshe. 700 bizneset do të pajisen me një deklaratë e cila do të paraqesë angazhimin e bizneseve që do të bëhen pjesë e Iniciativës Përdor më Pak Plastikë.



Rezultatet:

- Mbi 700 biznese HoReCa kanë filluar të reduktojnë përdorimin e plastikës një përdorimshe
- Mbi 15 alternativa miqësore me mjedisin për reduktimin dhe zëvendësimin e plastikës një përdorimshe iu ofruan bizneseve

AKTORËT	PARTNERËT	DONATORI
700 biznese të sektorit Horeca 9 koordinatorë lokalë 14 bashki	MedWaves, Save the Med Foundation	GIZ-Shqipëri

Monitorimi i nivelit të mërkurit në Parkun Kombëtar të lumit Vjosa

korrik 2023- shtator 2024

Bazuar në rëndësinë e monitorimit të nivelit të mërkurit në Shqipëri, Milieucontact do të bëjë një hartë të nivelit të mërkurit në pellgun e Lumit Vjosa. Lumi Vjosa konsiderohet si lumi i fundit i egër në Evropë, për mbrojtjen e tij ka pasur ndjeshmëri në nivel botëror. Përgjatë rrjedhës së tij ka shkarkime të ujërave të zeza (pa trajtim) nga një sërë qendrash urbane, të cilat njihen përgjithësisht për nivelin e lartë të ndotësve. Zona e Memaliajt, duke qenë prej vitesh minierë qymyri, ka kontribuar në depozitimin e ndotësve të ndryshëm. Qymyri dihet se përmban metale të rënda dhe mërkur. Lumi Vjosa dhe degët e tij kalojnë pranë qyteteve të Vlorës dhe Fierit, të ekspozuar ndaj aktiviteteve industriale. Vlerësimi shkencor dhe cilësor i ujit të Vjosës, do të ndërgjegjësojë politikën dhe aktorët e tjerë për të mbrojtur dhe ruajtur ekosistemin duke i dhënë statusin më të lartë të Parkut Kombëtar.



Rezultatet:

- Hartëzimi i nivelit të Hg në sedimentet dhe biotën e Lumit Vjosa dhe degëve të saj.
- Studim mbi nivelin e Hg në sedimentet dhe biotën e lumit Vjosa.
- Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut për ndikimin e Hg në shëndet dhe mjedis.



AKTORËT	PARTNERËT	DONATORI
Banorët përgjatë Lumit Vjosa; NJQV të basenit Vjosë; Studentë të Fakultetit të shkencave të Natyrës.	Departamenti i Kimisë pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës	UNDP përmes Global Environment Facility/Small Grants Programi GEF/SGP

Mission4Water

shtator 2024- gusht 2027

Projekti synon të shfrytëzoj potencialin inovativ të SMEve për të zhvilluar zgjidhje krijuese që mund të reduktojnë përhapjen e ndotësve në ujëra me fokus tekstilet dhe pajisjet elektroshtëpiake. Fokusi tematik i projektit është zhvillimi i inovacionit të gjelbër dhe teknologjive të pastra. Projekti MISSION4WATER synon të sjellë një inovacion rrënjësor në katër zinxhirë vlerash komplementarë: transformimi i polimereve, veshjet dhe tekstilet, pajisjet shtëpiake, si dhe trajtimi dhe pastrimi i ujërave.

Duke nxitur bashkëpunimin midis SME-ve dhe organizatave të tjera, do të jetë e mundur të identifikohen aplikime të reja për kompetencat ekzistuese, si dhe të promovohet adoptimi i teknologjive të reja, duke mundësuar krijimin e industrive të reja.



Rezultatet:

- Shfrytëzimi i potencialit inovativ të SME-ve për të zhvilluar zgjidhje inovative që mund të reduktojnë përhapjen e ndotësve në ujëra, me fokus kryesisht tekstilet, por edhe pajisjet elektroshtëpiake.

- Organizimi i punëtorive, trajnime, leksione dhe seminare online me aktorë të ndryshëm (universitete, studentë, SME, OJQ, institucione publike dhe private), duke përfshirë identifikimin e iniciativave për ndarjen e njohurive midis palëve të interesuara.
- Ofrimi i njohurive specifike për SME-te mbi parimet e ekonomisë qarkulluese, aftësitë dhe zgjidhjet inovative për të adresuar sfidat e clirimit të ndotësve në ujë.

AKTORËT	PARTNERËT	DONATORI
Universitete, studentë, SME, OJQ, institucione publike dhe private.	POLIMI dhe ROLD Itali; Planet Care Slloveni; Shoqata e Tregtimit të Tekstileve- Klusteri Tekstile, Maqedonia e Veriut; HEIS Bosnja&Herzegovina; Universiteti i Zagrebit, dhe IDA, Kroaci; Zero Mbetje Mali i Zi, GOGreen Maqedonia e Veriut	Interreg VI - B IPA Adriatic Ionian – IPA ADRION Programi i Bashkëpunimit 2021-2027

Politika dhe legjislacioni mjedisor



Komunitete e energjie të drejta për gjinitë dhe shoqërinë Shqiptare

dhjetor 2023 - nëntor 2025

Tranzicioni i energjisë paraqet një mundësi të rëndësishme për të adresuar deficietet gjinore që janë rezultat i drejtpërdrejtë i modelit të centralizuar të energjisë me bazë fosile dhe për të futur parimet e barazisë gjinore në sistemet energjetike. Aksesimi në energji duhet të lidhet me një axhendë që sfidon stereotipet e rolit të grave dhe që avancojnë të drejtat, dinjitetin dhe përfshirjen e tyre në rolet të ndryshme si konsumatore, prodhuese, investitore, eksperte, nëna dhe agjente të ndryshimit.

Objektivi final i projektit është që prodhuesit dhe konsumatorët të bëhen 'prosumatorë' dhe të mund të marrin pjesë aktivisht, individualisht ose përmes komuniteteve, në të gjitha tregjet me koncepte të decentralizuara dhe pjesëmarrëse. Energjia e komunitetit me bazë burimet e rinovueshme njihet nga legjislacioni në fuqi. Do të formulohen rekomandime konkrete të politikave për të zgjeruar mundësitë e angazhimit dhe pjesëmarrjes për qytetarët dhe si të bëhen pjesë e sistemit të përgjithshëm të energjisë.



Rezultatet:

- Analiza gjinore e sektorit të energjisë.
- Analiza e procedurave dhe si të përmirësohet praktikisht zbatimi i ngritjes së Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme.
- Ngritja e kapaciteteve të grave sipërmarrëse, transferimi i njohurive tek të rinjtë dhe rrjetëzimi me aktorë ndërkombëtarë.
- Planifikimi dhe advokimi i zgjidhjeve të politikave për Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme me bazë gjinore.



AKTORËT	PARTNERËT	DONATORI
Ente publike, sipërmarrje të drejtuara nga gratë; OSHC-të.	WECF Gjermani	DBU

Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme për rajonet e BE-së (REC4EU)

mars 2024 - shkurt 2028

REC4EU është projekti i parë i bashkëpunimit territorial që lehtëson përfshirjen e Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme, që me vendosjen dhe transpozimin nga shtetet anëtare të kuadrit të ri të përbashkët legjislativ i BE-së (EU2018/2001 REDII).

Projekti REC4EU kontribuon në një tranzicion më të gjelbër, me nivel të ulët të karbonit drejt një objektivit të kohezionit të BE-së në ekonomi me zero karbon.

Përmes REC-ve, prodhimi, furnizimi, shpërndarja dhe konsumi i BRE-ve kryhet kolektivisht nga qytetarët, shpesh në partneritet me NVM-të dhe autoritetet lokale. Megjithatë, krijimi dhe funksionimi i REC-ve është kompleks. Ato kërkojnë investime fillestare, njohuri legjislative, afërsi me burimet e rinovueshme të energjisë, një grup koheziv dhe të përkushtuar të palëve të interesuara dhe pjesëmarrje të administratave vendore.

REC4EU adreson këto sfida duke përforcuar ose krijuar sisteme mbështetëse rajonale për krijimin ose zhvillimin e REC-ve. Ai kërkon të forcojë metodën e qeverisjes së administratave publike dhe kapacitetin e tyre për të mbështetur të gjithë procesin, duke përfshirë aktorët përkatës.

Rezultatet:

- Analiza e barrierave teknike, rregullatore, ekonomike, sociale ndaj REC-ve;
- Identifikimi i aspekteve kyçe të politikave rajonale për të krijuar një kuadër të integruar të qeverisjes dhe mbështetjes për krijimin dhe zhvillimin e REC-ve;
- Hartimi dhe zbatimi i politikave të përmirësuara për të zhvilluar një sistem të integruar të qeverisjes dhe mbështetjes në nivel territorial;
- Ndërtimi i kapaciteteve të autoriteteve publike dhe palëve të interesuara për të realizuar shërbime mbështetëse për REC-të.



AKTORËT	PARTNERËT	DONATORI
Autoritetet publike të autonomisë vendore dhe Agjencia e Eficencës së Energjisë.	Agjencia Rajonale për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Burimeve Itali; Qeveria Rajonale e Toskanës; Agjencia Sllovaqe e Inovacionit dhe Energjisë; Voivodeship Lubelskie; Këshilli i Rajonit Tampere; Komuna Energjike Belgjike; Agjencia Andaluziane e Energjisë; Agjencia Lokale e Energjisë dhe Klimës; Agjencia për Zhvillimin Rajonal Serbi	Interreg Europe, bashkëfinancuar nga BE

Shikueshmëria dhe media

05

Përgjatë punës së përditshme kemi dokumentuar dhe bërë të dukshëm aktivitetet dhe nismat tona, nëpërmjet të cilave rezultate, gjetje dhe fakte të ndryshme janë ndarë me median vizive, të shkruar dhe atë sociale.





Artikuj ne median e shkruar

06

Konferenca e II Ndërkombëtare shkencore mbi Shëndetin Publik dhe Mjedisin 4 korrik, 2024

Ndotja e ajrit, edhe në përqendrimet të ulëta, është një kërcënim i madh mjedisor dhe për shëndetin e njeriut. Mungesa e monitorimit dhe gjurmimit bën që jo vetëm të mos matet dot ndikimi në shëndet, por edhe të mos merren politikat e duhura si në nivel lokal dhe në atë kombëtar.



MILIEUKONTAKT

Encouraging citizen participation in the energy transition

2023-2024 Albania

Project summary

This project aims to promote renewable energy and encourage citizen participation in the energy transition, while strengthening gender equality. It specifically targets Albanian female entrepreneurs in rural areas, low-income households, and young people through training and exchange events.

Vullana Mazreku
Founder and director of Milieukontakt Albania

"We are happy to be part of the ecofeminism project, it gives us many opportunities to work on the cross issues such as energy and gender. For the first time in Albania, stakeholders are briefed on energy and gender issues."

Achievements

- A **gender analysis of the energy sector** was carried out. Following that, an assessment report on current state of gender aspects in the energy sector was written.
- An **analysis of procedures and how to improve the practical implementation** for decentralised renewable energy projects was carried out on the basis of a legal framework review and interviews.
- Through the first activities of national and international importance, the project reached more than **130 persons** from Albania, the Balkan region, and at a European and global level.

Promovimi i energjisë së rinovueshme dhe mbështetja e sipërmarrjeve të drejtuara nga gra dhe të reja është fushata me e fundit e Milieukontakt Shqipëri.

07

Botime



Vlerësimi i ndotjes së Lumit Vjosa nga Mercuri në ujë, sedimente dhe biotë.

Për realizimin e këtij raporti ka punuar një ekip me profesorë dhe doktorantë nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i kimisë, të cilët përcaktuan metodologjinë, pikat e marrjes së mostrave, realizimin në terren, analizimin dhe hartimin përfundimtar.

Kosova dhe Shqipëria: Gjendja e kornizës politike për rritjen e efikasitetit energjetic në ndërtesa

Në këtë raport ne japim një vështrim të përgjithshëm të politikave dhe dokumenteve kryesore ekzistuese në Kosovë dhe Shqipëri, duke përfshirë një vlerësim të shkurtër të përputhshmërisë së tyre me politikat e nivelit europërendimor.





Kosova dhe Shqipëria: Gjendja e kornizës politike për rritjen e efikasitetit energjetic në ndërtesa
Versioni anglisht i botimit

Konkluzione nga konsultimet e aktorëve kryesorë mbi çështjet dhe barrierat më të rëndësishme në sektorin e ndërtimit në Kosovë dhe Shqipëri. Raporti paraqet një pasqyrë të përgjithshme të statusit aktual, sfidave dhe rekomandimeve për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesa në Kosovë dhe Shqipëri. Raporti thekson nevojën për mbështetje të konsiderueshme financiare, fushata të përforuara të ndërgjegjësimit publik dhe zbatim më të rreptë rregullator për të arritur objektivat e efikasitetit të energjisë.



Udhëzues mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm - Është një broshurë trajnimi praktik, që ndihmon dhe motivon mësuesit dhe nxënësit, të rrisin nivelin e informimit mbi OZHQ-të. Të rinjtë luajnë një rol të rëndësishëm në arritjen e OZHQ-ve ata shpesh kanë perspektiva të reja të guximshme, talent dhe aftësi në nxitjen e ndryshimeve dhe formimin e një shoqërie më të mirë në të ardhmen. Mësuesit do të gjejnë informacione ndihmëse, këshilla dhe fakte interesante nga vendi, Kosova dhe më gjerë. Udhëzuesi prezanton aktivitete dhe lojra konkrete që të rinjtë mund të zhvillojnë për të rritur ndërgjegjësimin e tyre.



Kapitalizimi i vlerave kulturore, historike dhe natyrore të zonës së Mirditës - trajtohen çështjet si identifikimi dhe valorizimi i trashigimisë kulturore dhe natyrore në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik; Integrimi i grupeve vulnerabël në sektorët tradicionalë të artizanatit dhe turizmit me ndikim të thellë dhe transformues tek individët dhe komunitetet; Ndërtimi i kapaciteteve në ruajtjen e origjinalitetit të vlerave kulturore dhe historike; Historitë e suksesit të jetës reale.

Moduli Shërbimet turistike - është një material mësimor ndihmës që trajton elemente të një shërbimi turistik cilësor dhe i mëson të rinjtë jo vetëm si të mirëpresin turistin në bare e restaurante, por edhe si të promovojnë produktet turistike.



Moduli Guida Turistike - trajton principet bazë të një guide të mirë turistike, komunikimin, listë e cfarë duhet bërë dhe jo gjatë një guide turistike si dhe prezanton llojet e format e ndryshme të turizmit.

Moduli Punime me Dru dhe Pirografi - është një material bazë për të rinjtë që duan të zhvillojnë aftësitë e tyre në punimin me dru. Përveç teknikave të ndryshme në pikturë prezantohen dhe mjetet e ndryshme që mund të përdorin të rinjtë, si dhe rëndësinë e modelimit në ruajtjen e traditës dhe vecorive karakteristike të zonës.





Gjendja aktuale e gjinisë në sektorin e energjisë në Shqipëri

Ky raport ofron një analizë gjithëpërfshirëse të aspekteve gjinore në sektorin e energjisë në Shqipëri dhe eksploron potencialin për një tranzicion energjitik të drejtë nga ana gjinore dhe sociale. Duke u bazuar në njohuritë nga një anketë e gjerë që përfshin palët e interesuara në nivele të ndryshme, duke përfshirë agjencitë e energjisë, kompanitë e shërbimeve, OJQ-të, etj., raporti ofron një shqyrtim të detajuar të sfidave aktuale dhe mundësive të ardhshme.


Drejtësia gjinore në sektorin WASH – Rekomandime për Veprim

Në sektorin e ujit, kanalizimeve dhe higjienës (WASH), barazia gjinore nuk është vetëm një detyrim moral, por një domosdoshmëri praktike për promovimin e gjithëpërfshirjes, barazisë dhe fuqizimit për të gjithë. Duke njohur rolin kryesor të barazisë gjinore në nxitjen e një sektori WASH të qëndrueshëm dhe me ndikim, është thelbësore t'i jepet përparësi përfshirjes dhe barazisë në të gjitha nivelet dhe aspektet e punës.



Sigurimi i aksesit të barabartë në objektet e ujit, kanalizimeve dhe higjienës (WASH)

Qëllimi i rekomandimeve për veprim në këtë dokument është të risë aksesin, përfshirjen dhe sigurinë në objektet publike WASH. Duke advokuar për përmirësimin e infrastrukturës, programet e ndërgjegjësimin, nismat e angazhimit të komunitetit, përmirësimin e mirëmbajtjes dhe pastërtisë, masat e shtuara të sigurisë dhe përmirësimin e ndriçimit dhe dukshmërisë, ne synojmë të krijojmë mjedise që plotësojnë nevojat e të gjithë individëve, e askush të mos mbetet pas në qasjen në shërbimet bazë WASH.



Varfëria dhe produktet menstruale – Rekomandime për Veprim

Dokumenti trajton varfërinë menstruale, promovimin e shëndetit menstrual dhe menaxhimin e higjienës në Ballkan. Ai ndalet veçanërisht në pabarazitë në qasjen në ujë të pastër dhe higjienë, sfidat me të cilat përballen gratë dhe vajzat në menaxhimin e periodave të tyre. Zonat rurale në Ballkan shpesh përballen me vështirësi në aksesin e ujit të pastër, kanalizimeve të duhura dhe objektet shëndetësore jo të përshtatshme nga ana gjinore dhe perspektiva e shëndetit seksual e riprodhues të grave.

Raporti përmbledhës i ecuresë për vitin 2023

Çdo vit raporti na jep mundësi të vlerësojmë ndikimin e punës tonë dhe suksesin e iniciativave gjatë vitit të kaluar, si dhe të ndajmë këto arritje me grupet e interesit dhe publikun e gjerë.

Kemi punuar dhe do të vazhdojmë të punojmë çdo ditë, që të jetojmë në një botë më të mirë se ajo që gjetëm. E dimë, kemi një rrugë të gjatë përpara si dhe shumë punë për të bërë. Por, ne jemi të angazhuar si dhe mirëpresim të gjithë vullnetarët, për t'u bërë pjesë e rrugëtimit tonë.



Vizioni i së ardhmes

08

Milieukontakt Shqipëri ndërmerr partneritete për të përmirësuar cilësinë e jetës, duke rritur pjesëmarrjen e njerëzve dhe shoqërive për një zhvillim të qëndrueshëm.

Milieukontakt bashkëpunon me partnerë (ndër)kombëtarë, sepse problemet mjedisore nuk kanë kufi. Shumë nga sfidat aktuale mjedisore janë mbarë botërore. Në nivel lokal njerëzit mund të mbështeten dhe të mësojnë nga përvojat e të tjerëve që punojnë me të njëjtat probleme në pjesë të tjera të botës. Milieukontakt lidh njerëzit, organizatat dhe rrjetet që merren me të njëjtat sfida dhe duan të bashkëpunojnë drejt rritjes së pjesëmarrjes qytetare në përcaktimin e të ardhmes së tyre. Milieukontakt do të sigurojë njerëzit me mjetet dhe aftësitë për të përdorur mundësitë për pjesëmarrje, duke përfshirë trajnimin, këshillimin (ligjor) dhe asistimin. Proceset vendimmarrëse me pjesëmarrje janë thelbësore në këto partneritete. Milieukontakt fokusohet në ofrimin e mjeteve për pjesëmarrje në vendimmarrje dhe zbatimin e projektit.

Ngritja e kapaciteteve Të jesh një mjedisor do të thotë të mësosh gjatë gjithë jetës dhe kjo e bën çështjen interesante dhe sfiduese! Për të qenë efektive, një lëvizje mjedisore kërkon një sërë aftësish që nuk mësohen lehtësisht në shkollë apo në universitet. Mjedisorët duhet të dinë për gamën e gjerë të çështjeve të mbuluara nga 'mjedisi'. Energjia, ndryshimet klimatike, mbeturinat, menaxhimi i ujit, kanalizimet, kimikatet dhe bujqësia janë disa nga çështjet. Mjedisori duhet gjithashtu të jetë në dijeni të zhvillimeve në qarqet shkencore dhe politike. Sot, çdo gjë lidhet me ndryshimin e klimës dhe atë që do ose nuk do të sjellë në të ardhmen. Ndaj njohuritë duhen përditësuar për të qenë një partner me qeveritë dhe palët e tjera të interesuara. Përveç njohurive mbi çështjet globale, duhet ditur se çfarë po ndodh në vendin, rajonin, qytetin apo fshatin për veprime më efektive. Kjo do të thotë që mjedisorët vazhdimisht mësojnë dhe përshtatin njohuritë shkencore me punën e tyre të përditshme. Ata duhet t'i përkthejnë këto njohuri në politikë dhe veprime. Aftësitë e komunikimit janë thelbësore, siç janë ekspertiza ligjore dhe aftësitë negociuese. Ndonjëherë duhet t'i drejtohem gjykatës ose të negociojmë nëse, nuk ka ndonjë mënyrë tjetër. Ka shumë fusha të tjera në të cilat mjedisorët duhet të përgatiten për t'u bërë efektivë; p.sh si të jenë administrator të mirë, projektues, drejtues projekti, profesionist dhe të dinë se si të mundësojnë financimin e të gjitha punëve.

Përfshirja e qytetarëve Nuk ka pothuajse asnjë fushë përveç politikës mjedisore në të cilën përfshirja e qytetarëve është kaq e rëndësishme për suksesin e politikës qeveritare. Shumë çështje politike kanë të bëjnë me çështje të tilla si: sjellja, diferencimi i mbetjeve, lëvizshmëria, ruajtja e energjisë dhe mbrojtja e natyrës. Këto janë të gjitha fusha politike që mund të mbështeten nga instrumentet teknike dhe ligjore, por që në fund gjithmonë bazohen në mbështetjen e qytetarëve dhe në ndryshimin e qëndrimit dhe sjelljes. Milieukontakt zhvilloi metodologji për të frymëzuar qytetarët për të zhvilluar “Axhendën e Gjelbër” të tyre dhe, jo vetëm për t’u përfshirë në hartimin e politikave, por edhe për të qenë proaktive.

Zgjidhja e problemeve mjedisore Gjithçka që ka të bëjë me zhvillimin e një shoqërie të qëndrueshme. Për të arritur qëndrueshmërinë, duhet të zgjidhen problemet ekzistuese mjedisore dhe të zhvillohen koncepte (djep për djep), metoda (riciklimi) dhe mjete (pajisje me energji të ulët), për të parandaluar probleme të reja. Ndërtimi i kapaciteteve dhe përfshirja qytetare pa punuar në drejtim të zgjidhjes së problemeve nuk ka vlerë në arritjen e qëllimit.

Strategjia

Milieukontakt nuk mund të arrijë e vetme misionin e saj. Ne jemi pjesë e rrjeteve formale dhe joformale të njerëzve dhe organizatave që punojnë drejt përmbushjes së misionit tonë. Aftësia për të bashkëpunuar me organizatat komunitare dhe me donatorët, qeverinë dhe biznesin ndërkombëtar, është një nga pikat e forta të Milieukontakt.

Ne krijojmë aleanca strategjike dhe partneritete me organizatat e shoqërisë civile, autoritetet, bizneset dhe institucionet ndërkombëtare aktive për zhvillimin e qëndrueshëm ose çështje të tjera që lidhen me këtë temë si gjinia, shëndetësia dhe arsimi.

Ne zhvillojmë, përdorim dhe lehtësojmë metodat e pjesëmarrjes, shkëmbimin e informacionit, analizën dhe veprimtarinë midis palëve të interesuara dhe lidhim këtë qasje me zgjidhje praktike, me kosto efektive dhe të qëndrueshme për sfidat mjedisore.

Ne bashkëpunojmë me shkencëtarë (social) dhe institucione kërkimore për të hulumtuar, analizuar dhe zhvilluar më tej qasjen e Milieukontakt dhe metodat e punës.

Ne do të zbatojmë në punën tonë të përditshme kodin tonë të sjelljes me rregullat për sjellje për të luftuar korrupsionin në projekte dhe partneritete.

Transparenca dhe pasqyrat 09

financiare


Gjatë vitit 2024 Milieukontakt Shqipëri ka menaxhuar 12 projekte, me një vlerë financiare mbi 69 milion lekë. Në grafikun e mëposhtëm tregohen fondet sipas burimeve të financimit, ku fondet e ardhura për projektet e realizuara, janë burime financiare në masën:

Burimet e financimit




Shpërndarja e buxhetit për vitin 2024, sipas llojit të shpenzimeve buxhetore të të gjitha projekteve të zbatuara, pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm, ku:

Pesha e buxhetit



E parë në këndvështirmin e fushës së aktivitetit të Milieukontakt dhe shtyllave kryesore të punës sonë gjatë 2024, në grafikun e mëposhtëm është paraqitur pesha specifike e fondeve të përdorura për:



Projektet e zbatuara nga Milieukontakt gjatë vitit 2024, sipas llojshmërisë së shërbimeve dhe në funksion të të një mjedisi më të pastër dhe ekologjik, sipas peshës tyre specifike rezultojnë se janë përdorur për:



REDUKTIMIN E PLASTIKËS DHE
MBETJEVE

39%



EFIÇENCËN DHE ENERGJINË E
RINOVUESHME

31%



MONITORIMIN E CILËSISË AJRIT, UJIT,
ZHURMAVE

26%



REDUKTIMIN E KIMIKATEVE TË
RREZIKSHME

4%

Emertimi dhe Forma ligjore
NPT -I
Adresa e Selise

Data e krijimit
Nr. i Regjestrimit Tregetar

Veprimtaria: Kryesore

FONDACION "MILIEUKONTAKT SHQIPERI"
L01311454H
Rruga: "Xhoxhi Martini", Pallati Teuta Konstruksion, Shk. 3, Ap. 8.
Tirane
02.11.2009
Regjistruar me Vendim Gjykatë Nr. 316

"Te gjithesise nje lervije te forte demokratike te shoqatave
mijdesore te dukshme ne Shqiperi"

PASQYRAT FINANCIARE
(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr.2 te Permiresuar dhe
Ligji Nr. 9228 Date 29.04.2004 Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare)

Viti 2024

Pasqyra Financiare jane individuale
Pasqyra Financiare jane te konsoliduara
Pasqyra Financiare jane te shprehura ne
Pasqyra Financiare jane te numbluakapura ne

Peridhja: Kontabel e Pasqyrave Financiare

Data e mirblyes se Pasqyrave Financiare

Nga	01.01.2024
Deri	31.12.2024
	11.03.2025

Ushqesues

11.03.2025

MINISTERTI I TREGETISE DHE
INDUSTRIES
SHQIPERIA

FONDACIONI "MILIEUKONTAKT SHQIPERI"		
PASQYRAT FINANCIARE 2024		
AKTIVET	2024	2023
Mieste monetare dhe ekuivalente te tyre	44,910,434	27,386,265
Te drejta dhe interesi i arketueshem		
Kontribute te arketueshme		
Investime dhe shpenzime te parapaguara	44,910,434	27,386,265
Investime financiare afat gjate		
Aktive te kufizuara per investime ne toka, ndertesa dhe pajise		
Toka, ndertesa dhe pajise		
Investime te tjera afatgjate	670,122	532,065
Totali i aktiveve	45,580,556	27,918,265
DETYRIMET		
Te pagueshme	992,452	1,138,873
Deftesa te pagueshme		
Kontribute te marra ne avance		
Grante	44,588,104	26,779,388
Premtime te kushtezuara per te dhene		
Hua afat gjate	0	
Totali i detyrimeve	45,580,556	27,918,265
AKTIVE NETO		
Te kufizuara		
a) Toka ose vepra arti te te dhunuara per tu perdorur per qelile specifike me perscakim qe te ruhen apo te mos shiten		
b) Aktive te dhunuara me qelile per t'u investuar dhe siguruar prej tyre burime te perzhveshje te ardhurash		
Te pakufizuara		
Totali i Aktiveve NETO		

PASQYRAT E AKTIVITETEVE (PERFORMANCES)		
Pershkrimi i Elementeve	2024	2023
Ndryshimi ne aktive neto te pakufizuara		
Te anthurat:		
Te anthuru nga tarifat e antarimit		
Te anthuru nga donacionet dhe kontributet vullnetare		
Te anthuru nga grantet dhe kontraktet e tjera financiare	24,226.405	18,365.728
Te anthuru nga investimet apo dhuratimet		
Te anthuru nga tarifat e shpirtoreme		
Te anthuru nga aktivitetet te tjera		
Te anthuru te tjera		
Totali i te anthurave nga aktivitetet neto te pakufizuara	24,226.405	18,365.728
Aktive neto te ciluara nga kufizimet:		
Realizimi i kufizimeve te programit		
Realizimi i kufizimit per blerjen e paqesve		
Perfundimi i kufizimit te shfata		
Totali i aktiviteteve neto te ciluara nga kufizimet		
Totali i te anthurave neto te pakufizuara:		
Shpenzime per aktivitetet		
Aktiviteti 1 (Empower Me4)	-	4,103.214
Aktiviteti 2 (EU4G - RENOVIA)	2,551.900	145.708
Aktiviteti 3 (GEP/SGP)	1,009.838	659.060
Aktiviteti 4 (Green all)		998.341
Aktiviteti 5 (Bashkia Tiranë)	899.750	309.381
Aktiviteti 6 (WSP/SP)	86.659	201.088
Aktiviteti 7 (UNDP - EU4G)		5,887.678
Aktiviteti 8 (BECO)	742.633	6.306
Aktiviteti 9 (RELOAD) - VVB	5,452.145	
Aktiviteti 10 DBU	2,604.116	
Aktiviteti 11 Rec4EU	1,168.478	
Aktiviteti 12 Eco4emission	490.750	
Aktiviteti 13 M4W	754.577	
Aktiviteti 14 (M4OWAVE)		6,054.000
Aktiviteti 15 (BFI) - manuali	292.620	
Aktiviteti 16 LPZ	8,072.960	
Shpenzimet administrative dhe te tjera te pergjithshme		
Prism dhe mjetet fondacion		
Totali i shpenzimeve	24,226.405	18,365.728
Rrjetja/Rritja ne aktivitet neto te pakufizuara (A)	45,880.585	27,918.265
Ndryshimi ne aktive neto te kufizuara		
Kontributet:		
Te anthuru nga investimet afat gjate		
Firmi i rehatuar dhe i penebluar nga investimet afatgjate		
Humbja aktuale nga obligacionet vjetor		
Aktiviteti neto te ciluara nga kufizimet (me shprehje minus)		
Rrjetja/Rritja ne aktivitet neto perkoheshik te pakufizuara (B)	670.122	532.065
Ndryshimi ne aktivitet neto (A+B)	46,550.707	28,450.333
Aktiviteti neto te ciluara te vjet	27,388.205	25,727.768
Aktiviteti neto ne fund te vjet	44,810.434	21,622.768